



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. 175, Datë 12/09/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 85, datë 08.06.2018, e Znj. B. N. (Gj.), ku pretendohet diskriminim, për shkak të “bindjeve politike” dhe “përkatësisë prindërore”, nga ana e Ministrisë së Brendshme.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur, rezulton se Znj. B. N. është lindur në Itali, në datën 05.09.1959. Babai i saj, N. Gj. ka qenë qytetar shqiptar dhe nëna e saj ka qenë qytetare italiane². Ankuesja gëzon nënshtetësinë amerikane, pasi familja e saj, prej shumë vitesh, ka emigruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Aktualisht, ankuesja disponon leje qëndrimi³, të lëshuar nga Ministria e Brendshme,

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

² Prindërit e ankueses kanë ndërruar jetë.

³ Leja e qëndrimit është e vlefshme nga data 12.06.2017, deri në 13.07.2026.

për të qëndruar në Shqipëri. Në datën 04.08.2017⁴, ankuesja ka depozituar pranë Komisionarit të Policisë Shkodër, kërkesën e saj për njohje të shtetësisë shqiptare. Në zbatim të pikës 15/III, të Udhëzimit të Përbashkët nr. 4573, datë 12.07.2013, të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, “Për procedurat, afatet dhe dokumentacionin e kërkesave për njohje të shtetësisë shqiptare, shqyrtimin e tyre, si dhe formën dhe mënyrat e plotësimit të kërkesës për përfitim të shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare”, Policia e Shkodrës e ka përcjellë praktikën pranë Ministrisë së Brendshme. Ankuesja pretendon se pavarësisht se kanë kaluar afatet ligjore⁵, brenda të cilave, kërkesa e saj duhet të ishte shqyrtuar, Ministria e Brendshme nuk është shprehur ende, në lidhje me këtë kërkesë, ndërkohë që ka përfunduar shqyrtimi dhe miratimi i të gjithë kërkesave për njohje shtetësie⁶, të depozituara pranë këtij institucioni.

Për sa më sipër, në kushtet kur, kërkesa e saj zvarritet prej 4 muajsh nga Ministria e Brendshme, ankuesja pretendon se diskriminohet për shkak të bindjeve politike dhe përkatësisë prindërore, pasi ajo është mbesa e Gj. M., i cili ka qenë i njohur për aktivitetin e tij, kundër diktaturës komuniste. Znj. B. N. pretendon se një fakt i tillë është i njohur botërisht dhe për këtë fakt ka dijëni edhe Ministria e Brendshme dhe titullari i saj.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Fillimisht, strukturat përkatëse të Komisionerit kontaktuan me e-mail në datën 13.06.2018 me ankuesen, duke i kërkuar të dhëna të mëtejshme, lidhur me ankesën e depozituar pranë KMD-së, si dhe iu kërkuar informacion, nëse Z. D. D., i cili kishte dërguar informacion pranë KMD-së mbi çështjen e parashtruar nga ankuesja, kishte marrë autorizim prej saj.

⁴ Referuar e-mailit të datës 08.08.2017, të Policisë së Shtetit drejtuar Z. D. D., rezulton se data e saktë e depozitimit të dokumentacionit të plotë të ankueses pranë këtij institucioni është 04.08.2018.

⁵ Në pikat 6 dhe 7, të Vendimit nr. 554, datë 03.07.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave për njohjen ose fitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare, me përjashtim të shtetasve të Republikës së Kosovës parashikohet:

“6. Strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Brendshme, së bashku me zyrat e Gjendjes Civile, shqyrtojnë dokumentacionin që provon origjinën shqiptare të të paralindurit, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi dhe paraqesin mendimin e tyre me shkrim pranë Ministrit të Brendshëm jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas marrjes së kërkesës në përputhje me këtë vendim.

7. Ministri i Brendshëm propozon dhënien e shtetësisë shqiptare personit me origjinë shqiptare, në bazë të pikës 7 të nenit 9 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, të ndryshuar, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas paraqitjes së mendimit sipas pikës 6 të këtij kreu. Vendimi i Ministrit të Brendshëm i dërgohet menjëherë Presidentit të Republikës.”

⁶ Ankuesja pretendon se në datën 24.04.2018, Ministria e Brendshme e ka konfirmuar një fakt të tillë.

1. Me e-mailin e datës 17.06.2018, Znj. B. N. e bën me dije Komisionerin, lidhur me çështjet për të cilat është kërkuar informacion, si dhe autorizon Z. D. D. për të kontaktuar me KMD, lidhur me çështjen në shqyrtim. Pavarësisht se autorizimi nuk është prokurë e posaçme, ky akt u konsiderua nga Komisioneri, si marrje pëlqimi për përfaqësim nga ana e ankueses.

- B. Në vijim të dërgimit të informacionit plotësues nga Znj. B. N. (Gj.), pas analizimit të ankesës nr. 71, datë 22.05.2018, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- C. Mbështetur në nenin 33, pika 7⁷, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Z. F. Xh., Ministër i Brendshëm dhe për dijëni ankueses, me shkresën nr. 836/1, datë 18.06.2018, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjen e parashtruar nga ankuesja, si dhe iu kërkuua të dërgoheshin aktet e poshtëcituarat:
 - Korrespondenca zyrtare shkresore me ankuesen. (kërkesa të ankueses dhe përgjigjet zyrtare të Ministrisë së Brendshme);
 - Korrespondenca nëpërmjet e-mailit zyrtar të Ministrisë së Brendshme me ankuesen;
 - Çdo informacion tjetër, që ka lidhje me çështjen e parashtruar nga ankuesja.

1. Në kushtet kur, Ministria e Brendshme nuk i dërgoi përgjigje shkresës së sipërpërmendur, Komisioneri iu drejtua këtij institucioni sërish me shkresën nr. 836/2, datë 20.07.2018, duke i bërë kujtesë për kthim përgjigje.

2. Në përgjigje të shkresës nr. 836/2, datë 20.07.2018, së Komisionerit, Ministria e Brendshme dërgoi shkresën nr. 836/5, datë 02.08.2018, nëpërmjet së cilës bën me dije se kërkesa e Znj. B. N. për njohje të shtetësisë shqiptare është objekt i ndryshimeve ligjore, të cilat priten të miratohen së shpejti. Sipas shkresës në fjalë, një nga risitë e ligjit të ri do të jetë pikërisht aplikimi nëpërmjet origjinës shqiptare. Në projektligjin e ri për shtetësinë

⁷ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

shqiptare, i cili është në fazën e hartimit, është parashikuar përfshirja e kritereve dhe dispozitave procedurale në aktin ligjor përkatës, duke unifikuar dhe shmangur referencat me anë të një Vendimi të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Europian.

- D.** Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhërin nr. 144, datë 31.07.2018, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit pranë Ministrisë së Brendshme, për verifikimin e pretendimeve të ankueses Bianca B. N. (GJ), në datën 06.08.2018, u krye inspektim pranë Ministrisë së Brendshme.

Gjatë inspektimit të kryer pranë Ministrisë së Brendshme, inspektorët e KMD-së u informuan mbi faktin se dosja me praktikën e Znj. B. N. ishte trajtuar nga strukturat përkatëse të këtij institucioni, si dhe ishte plotësuar me përgjigjet e institucioneve përgjegjëse, të cilave Ministria e Brendshme u kishte kërkuar informacion dhe kryerje verifikimesh mbi ankuesen. Në vijim të plotësimit të dosjes së ankueses, në datën 02.02.2018, Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë i është drejtuar Ministrit të Brendshëm, me Memo, ku evidentohet fakti se dokumentacioni përkatës është i rregullt dhe kërkohet miratimi i tij. Në vijim të Memos së datës 02.02.2018, Drejtoria e Shtetësisë ka përcjellë për miratim pranë Ministrit të Brendshëm, Memon e datës 20.03.2018. Të dyja Memot kanë dalë nga Ministri i Brendshëm, pa shënimet përkatëse, se si do të veprohej në vijim me praktikën e Znj. B. N. (GJ). Të pyetur në lidhje me tejkalimin e afatit ligjor për praktikën e ankueses, strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Brendshme u përgjigjën se vonesa ka ardhur si rrjedhim i dërgimit me vonesë të përgjigjeve zyrtare nga institucionet përgjegjëse, të cilat kanë kryer verifikimet përkatëse mbi Znj. B. N. Në vijim procedura ka qenë diskrecion i Ministrit të Brendshëm. Personat përgjegjës pranë Drejtorisë së Azilit dhe Shtetësisë informuan se në bazë të dy Memove të përcjella drejt Ministrit të Brendshëm rezultoi se nuk ka patur asnjë pengesë ligjore për Znj. B. N., për të përfituar shtetësinë shqiptare. Inspektorët e KMD-së kërkuan të merrnin në administrim kopje të dy Memove, por kjo nuk u arrit, pasi informacioni konsiderohej konfidencial. Memot mbanin datat përkatëse, por jo numër protokolli.

Strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Brendshme theksuan faktin se nuk kanë patur asnjë korrespondencë zyrtare me ankuesen B. N., e cila nuk ka depozituar ankesë pranë Ministrisë së Brendshme, lidhur me çështjen e përfitimit të shtetësisë. Këto struktura theksuan faktin se është kërkuar informacion me e-mail mbi çështjen e Znj. B. N. nga Z. D. D., i cili është vetëdeklaruar si përfaqësues i ankueses, por pa patur asnjë prokurë për ta përfaqësuar atë.

Të pyetur nëse ka praktika të individëve të tjerë, të cilat kanë mbetur pezull, sikurse praktika e Znj. B. N., strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Brendshme u shprehën se kishte edhe praktika të tjera për njohje/fitim shtetësie, për të cilat nuk ishte vendosur ende. Aktualisht është kryer një

pezullim *de facto* (pa urdhër me shkrim të Ministrit të Brendshëm), lidhur me propozimet për dhënie shtetësie. Kjo ka ndodhur pasi në shtator 2018 pritet të miratohet projektligji i ri “Për shtetësinë”, i cili ka përfshirë edhe parashikimet e Vendimit nr. 554, datë 03.07.2013, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave për njohjen ose fitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare me përjashtim shtetasve të Republikës së Kosovës”. Në këtë projektligj parashikohen procedura lehtësuese, lidhur me fitimin e shtetësisë së individëve me statusin e ankueses. Për sa më sipër, u ra dakord që informacion më i detajuar lidhur me këto praktika do të dërgohej me e-mail në adresë të Komisionerit në ditët në vijim.

E. Në vijim të inspektimit të kryer, Ministria e Brendshme dërgoi me e-mail në datën 08.08.2018, informacion lidhur me atë pjesë të objektit të inspektimit, që kishte të bente me identifikimin e kërkesave të tjera për njohje/fitim shtetësie, nga shtetës të tjerë me origjinë shqiptare, procedurat për të cilat ishin “ngrirë”, sikurse për ankuesen.

Sipas informacionit të dërguar rezultoi se numri i aplikimeve për njohje të shtetësisë shqiptare, për të cilat nuk është marrë vendim për propozim shtetësie nga ana e Ministrit të Brendshëm, sikurse për praktikën e Znj. B. N. (GJ.), është 14 të tilla.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

1. Znj. B. N. (GJ.) është lindur në Itali, në datën 05.09.1959. Babai i saj, N. Gj. ka qenë qytetar shqiptar dhe nëna e saj ka qenë qytetare italiane. Ankuesja gëzon nënshtetësinë amerikane, pasi familja e saj, prej shumë vitesh, ka emigruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Duke qenë se ajo plotëson kushtet e parashikuara në nenin 7, të ligjit nr. 8389, datë 05.08.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, si dhe në akte të tjera nënligjore, të dala në zbatim të tij, përkatësisht Vendimi nr. 554, datë 03.07.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave për njohjen ose fitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare, me përjashtim të shtetasve të Republikës së Kosovës” dhe Udhëzimi i Përbashkët nr. 4573, datë 12.07.2013, e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, “Për procedurat, afatet dhe dokumentacionin e kërkesave për njohje të shtetësisë shqiptare, shqyrtimin e tyre, si dhe formën dhe mënyrat e plotësimit të kërkesës për përfitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare”, Znj. B. N. ka depozituar në datën

04.08.2017, kërkesën e saj për njohje shtetësie, me bazë përkatësie prindërore⁸, pranë Komisarariatit të Policisë Shkodër⁹.

Në referencë të pikës 15, të Udhëzimit të Përbashkët nr. 4573, datë 12.07.2013, të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, “Për procedurat, afatet dhe dokumentacionin e kërkesave për njohje të shtetësisë shqiptare, shqyrtimin e tyre, si dhe formën dhe mënyrat e plotësimit të kërkesës për përfitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare”, Komisarati i Policisë Shkodër e ka përcjellë dokumentacionin e Znj. B. N. brenda 15 ditëve pune pranë strukturës kompetente për shtetësinë, në Ministrinë e Brendshme.

Mbështetur në pikën 18, të Udhëzimit të sipërpërmendur, Ministria e Brendshme, brenda 7 ditëve nga mbërritja e praktikës pranë saj shqyrton të dhënat e deklaruara dhe përbërësit familjarë që provojnë gëzimin e shtetësisë shqiptare të prindit apo të paralindurit të subjektit kërkues në momentin e lindjes së kërkuesit. Në vijim, në bazë të pikës V/22, të Udhëzimit të Përbashkët parashikohet se kur vërtetohet se kërkuesi ka lindur nga njëri prind që ka pasur shtetësinë shqiptare në momentin e lindjes së kërkuesit, por që nuk është regjistruar në regjistrin e gjendjes civile dhe nuk ka hequr dorë nga shtetësia, Ministri i Brendshëm në bazë të propozimit nga struktura përkatëse konstaton faktin e shtetësisë në bazë të lidhjes familjare dhe e dërgon për regjistrim në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Nëse kërkuesi nuk është i regjistruar, njofton atë dhe zyrën e gjendjes civile të interesuar, e cila kryen veprimet përkatëse për regjistrimin dhe dhënien e numrit personal. Në këtë rast, vendimi përkatës dhe numri personal i identifikimit, i njoftohet zyrtarisht kërkuesit.

⁸ Në pikën 2 të Vendimit nr. 554, datë 03.07.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave për njohjen ose fitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare, me përjashtim të shtetasve të Republikës së Kosovës” parashikohet: “2.Shtetësia shqiptare, sipas këtij vendimi, u njihet ose u jepet: a)personave të lindur të paktën nga një prind, që zotëronte shtetësinë ose origjinën shqiptare në momentin e lindjes së kërkuesit, pavarësisht nga vendi i lindjes; b) personave, të paralindurit me shtetësi shqiptare të të cilëve nuk jetojnë më në momentin e paraqitjes së kërkesës, me kusht që të provohet lidhja familjare në vijë të drejtë e personit kërkues me të paralindurin, i cili ka zotëruar shtetësinë shqiptare;c) personave me origjinë shqiptare që kanë shtetësinë e një shteti anëtar të Bashkimit Europian, SHBA-së apo një shteti tjetër, shtetasit e të cilit mund të lëvizin pa viza në territorin e shteteve të zonës Shengen apo që janë me qëndrim me dokumentacion të rregullt në njërin prej këtyre shteteve;ç) personave me origjinë shqiptare që zotërojnë shtetësinë e një shteti tjetër ose janë pa shtetësi, kur njëri nga prindërit e kërkuesit zotëron shtetësinë shqiptare;d) personave, prindërit e cilëve janë persona me origjinë shqiptare që kanë shtetësinë e një shteti tjetër ose nuk kanë shtetësi dhe kur kërkuesi ka lindur në territorin e Republikës së Shqipërisë.”

⁹ Në referencë të pikës III/12, të Udhëzimit të Përbashkët nr. 4573, datë 12.07.2013, të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, “Për procedurat, afatet dhe dokumentacionin e kërkesave për njohje të shtetësisë shqiptare, shqyrtimin e tyre, si dhe formën dhe mënyrat e plotësimit të kërkesës për përfitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare”, ku parashikohet: “Kërkesa për njohjen e fitimit të së drejtës së shtetësisë shqiptare paraqitet pranë Komisariateve vendore të Policisë së Shtetit, të vendqendrimit të personit ose, në rast se personi banon jashtë shtetit, pranë përfaqësive diplomatike ose konsullore të RSH jashtë shtetit ose në përfaqësi të tjera në vendin, ku i interesuari banon ose ndodhet fizikisht”.

Në pikat 6 dhe 7, të Vendimit nr. 554, datë 03.07.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave për njohjen ose fitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare, me përjashtim të shtetasve të Republikës së Kosovës” parashikohet:

“6. Strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Brendshme, së bashku me zyrat e Gjendjes Civile, shqyrtojnë dokumentacionin që provon origjinën shqiptare të të paralindurit, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi dhe paraqesin mendimin e tyre me shkrim pranë Ministrisë së Brendshme jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas marrjes së kërkesës në përputhje me këtë vendim.

7. Ministri i Brendshëm propozon dhënien e shtetësisë shqiptare personit me origjinë shqiptare, në bazë të pikës 7, të nenit 9 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, të ndryshuar, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas paraqitjes së mendimit sipas pikës 6 të këtij kreu. Vendimi i Ministrisë së Brendshme i dërgohet menjëherë Presidentit të Republikës.”

Për sa më sipër, rezulton se afatet e përcaktuara nga Vendimi i sipërpërmendur dhe Udhëzimi i Përbashkët nr. 4573, datë 12.07.2013, i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, nuk janë respektuar nga ana e Ministrisë së Brendshme. Aplikimi i Znj. B. N. është depozituar në datën 04.08.2017, pranë Komisarariatit të Policisë Shkodër, i cili e ka përcjellë praktikën pranë strukturave përkatëse të Ministrisë së Brendshme, brenda afatit 15 ditor të përcaktuar në aktet e mësipërme, nënligjore. Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë ka paraqitur 2 Memo pranë Ministrisë së Brendshme, përkatësisht në datën 02.02.2018 dhe 20.03.2018, ku sikurse u evidentua gjatë hetimit administrativ, rezulton se nuk ka patur asnjë pengesë ligjore për Znj. B. N., për të përfituar shtetësinë shqiptare. Pavarësisht sa më sipër, Ministri i Brendshëm nuk është shprehur, nëse Znj. B. N. do t'i njëjhej shtetësia shqiptare.

Për sa më sipër, pavarësisht justifikimit të Ministrisë së Brendshme, se kërkesa e Znj. B. N. (GJ.) për njohje të shtetësisë shqiptare është objekt i ndryshimeve ligjore, të cilat priten të miratohen së shpejti, pra është “ngrirë” për shkak se pritet të miratohet projekt-ligji “Për shtetësinë”, Komisioneri gjykon se ankuesja i është ekspozuar një trajtimi të padrejtë dhe të paligjshëm, për sa kohë që ajo e ka depozituar kërkesën e saj për njohje shtetësie, ndërkohë që ligji nr. 8389, datë 05.08.1998 “Për shtetësinë shqiptare” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të sipërpërmendura të dala në zbatim të tij, kanë qenë dhe janë ende në fuqi. Komisioneri e përforcon dhe e mbështet idenë e mësipërme në faktin se Ministri i Brendshëm nuk ka nxjerrë asnjë akt administrativ, të brendshëm, nëpërmjet së cilit të zyrtarizojë pezullimin apo ngrirjen e procedurave për praktikën e Znj. B. N.

Nga informacioni i administruar gjatë hetimit administrativ rezultoi se procedurat për njohje shtetësie janë “ngrirë” edhe për 14 praktika të tjera, disa prej të cilave janë edhe më të hershme, sesa praktika e ankueses. Datat e aplikimit dhe numri i aplikuesve paraqitet si më poshtë:

- Në datën 16.12.2016 – 2 aplikime për njohje shtetësie;
- Në datën 10.02.2017 – 1 aplikim për njohje shtetësie;
- Në datën 23.05.2017 – 3 aplikime për njohje shtetësie;
- Në datën 15.06.2017 - 1 aplikim për njohje shtetësie;
- Në datën 02.08.2017 – 2 aplikime për njohje shtetësie;
- Në datën 03.08.2017 – 1 aplikim për njohje shtetësie;
- Në datën 07.09.2017 – 1 aplikim për njohje shtetësie;
- Në datën 12.12.2017 – 1 aplikim për njohje shtetësie;
- Në datën 02.02.2018 - 1 aplikim për njohje shtetësie;
- Në datën 15.02.2018 - 1 aplikim për njohje shtetësie;

Referuar informacionit të dërguar me e-mail në datën 03.04.2018, nga Ministria e Brendshme, për Z. D. D., rezulton se numri i kërkesave për njohje/dhënie shtetësie shqiptare nga muaji korrik 2017, deri në datën kur është dërguar e-maili, është 22 të tilla. Mbështetur në të dhënat e sipërpërmendura të përcjella sërish nga Ministria e Brendshme rezulton se për 16 aplikime për njohje/dhënie shtetësie, Ministri i Brendshëm ka marrë vendim për propozim dhënie/njohje shtetësie ose refuzim të saj, ndërsa për 6 (gjashtë) të tilla është ngrirë procedura përkatëse.

Për sa më sipër, referuar nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se ankuesja B. N. (GJ) i është ekspozuar një trajtimi të padrejtë, por jo të pabarabartë nga ana e Ministrisë së Brendshme, për sa kohë ngrirja/pezullimi *de facto* i procedurave për dhënie shtetësie është zbatuar edhe për aplikime/kërkesa të tjera për njohje/dhënie shtetësie.

2. Lidhur me pretendimin e Znj. B. N. (GJ), se në datën 31.10.2017, ka dërguar kërkesë me shkrim pranë Ministrisë së Brendshme dhe nuk i është kthyer përgjigje, rezulton se pranë Ministrisë së Brendshme nuk është depozituar asnjë kërkesë me shkrim e ankueses.

Ky fakt ka qenë objekt shqyrtimi administrativ edhe pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili nëpërmjet shkresës së tij nr.1537/3, datë 28.12.2017, e ka njoftuar ankuesen se pas komunikimit zyrtar me Ministrinë e Brendshme, kjo e fundit e ka informuar me shkresën nr 993/6, datë 22.12.2017, se nga ana e ankueses nuk është dorëzuar asnjë kërkesë me shkrim për ecurinë e trajtimit të aplikimit të saj për njohje shtetësie pranë këtij institucioni, por ndërkohë e bën me dije se po vijohet me ndjekjen e procedurave të

shqyrtimit dhe verifikimit të aplikimit të saj. Ndërkohë që, nga provat e depozituara nga ankuesja rezulton se komunikimi me Ministrinë e Brendshme, lidhur me çështjen e saj, është mbajtur nga Z. D. D. Z. D. D. ka komunikuar me e-mail me zyrtarë të ndryshëm të Ministrisë së Brendshme, nga të cilët ka marrë përgjigjet përkatëse, lidhur me çështjen e Znj. B. N.

Për sa më sipër, nga e-mailet e depozituara në cilësinë e provës pranë Komisionerit, rezulton se Z. D. D., pavarësisht faktit se nuk ka qenë përfaqësues me prokurë i Znj. B. N., ka marrë informacion me e-mail, në datën 05.02.2018 e në vijim, mbi statusin e aplikimit të saj për njohje shtetësie apo edhe mbi çështje të tjera për të cilat ka kërkuar informacion, nga Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë, pranë Ministrisë së Brendshme.

Për sa më sipër, referuar nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se ankuesja B. N. (GJ), pavarësisht shkeljeve ligjore, nuk i është ekspozuar një trajtimi të pabarabartë nga ana e Ministrisë së Brendshme.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në ankesën nr. 85, datë 08.06.2018, e Znj. B. N. (GJ) pretendohet diskriminim, për shkak të “*bindjeve politike*” dhe “*përkatësisë prindërore*”, nga ana e Ministrisë së Brendshme.

“Bindja politike” dhe “përkatësia prindërore” janë dy prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

1. Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, Komisioneri gjykon se “bindja politike” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme që e justifikojnë si të tillë. Sikurse rezulton nga dokumentet shkresore të

depozituara¹⁰ nga ankuesja pranë KMD-së, ajo është mbesa e Gj. M., i cili është i njohur për veprimtarinë e tij anti regjimit të vendosur në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore.

2. Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “përkatësisë prindërore”, Komisioneri gjykon se “përkatësia prindërore” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur. Njëkohësisht, nga dokumentacioni i depozituar pranë KMD-së rezulton se Znj. B. N. është e bija e N. Gj. Gj., shtetas shqiptar.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

1. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “bindjen politike”.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se Znj. B. N. (GJ) është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë nga ana e Ministrisë së Brendshme, lidhur me zvarritjen e procedurave për njohjen e shtetësisë. Por, sikurse u konstatua edhe nga analiza në seksionin e mësipërm, rezulton se e njëjta zvarritje procedurash ka ndodhur edhe për 14 praktika të tjera, 6 prej të cilave janë depozituar nga muaji gusht 2017 e në vijim. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se nuk ekziston një lidhje shkakësore ndërmjet trajtimit të padrejtë ndaj së cilit është ekspozuar Znj. B. N. (Gj), nga Ministria e Brendshme, me bindjet politike të ankueses.

2. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “përkatësinë prindërore”.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, duke përdorur të njëjtën vijë llogjike me shkakun paraardhës të pretenduar nga ankuesja, Komisioneri gjykon se për sa kohë ekzistojnë edhe praktika të tjera të zvarritura për njohje/dhënie shtetësie nga ana e Ministrisë së Brendshme, në rastin konkret nuk ekziston një lidhje shkakësore ndërmjet trajtimit të padrejtë ndaj së cilit ankuesja është ekspozuar nga institucioni i sipërpërmendur, me përkatësinë e saj prindërore.

¹⁰ Referuar Vendimit nr. 308 (51-2013-4243), datë 29.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; Vendimit nr. 308 (51-2013-4243)/1, datë 29.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; Çertifikatës familjare nr. 005829596, lëshuar në Shkodër në datën 17.02.2015, në bazë të regjistrit V.Shanto 17/113; <https://gjonmarkagjoni.com/kapidan-ndue-gjonmarkaj/>

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenit 7, të Ligjit nr. 8389, datë 05.08.1998 “Për shtetësinë shqiptare” (i ndryshuar) të pikave 6 dhe 7, të Vendimit nr. 554, datë 03.07.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave për njohjen ose fitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare, me përjashtim të shtetasve të Republikës së Kosovës, si dhe pikave 15, 18 dhe 22 të Udhëzimit të Përbashkët nr. 4573, datë 12.07.2013, të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, “Për procedurat, afatet dhe dokumentacionin e kërkesave për njohje të shtetësisë shqiptare, shqyrtimin e tyre, si dhe formën dhe mënyrat e plotësimit të kërkesës për përfitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të Znj. B. N.(GJ), për shkak të “bindjeve politike” dhe “përkatësisë prindërore”, nga ana e Ministrisë së Brendshme.
2. Rekomandohet që, Ministria e Brendshme të përfundojë procedurat për njohjen e shtetësisë së ankuseses, duke zbatuar legjislacionin në fuqi.
3. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

(Shkak – bindja politike
Fusha – të mira dhe shërbime)